

“Nga Fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë”

**Raport vlerësimi i Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve
dhe Mentorimit**

Përmbajtja

❖ Hyrje.....	3
❖ Objektivat e trajnimeve.....	3
❖ Organizimi i tyre.....	4
❖ Metodologjia e vlerësimit.....	4
❖ Rezultatet e pyetësorit para trajnimeve.....	5
❖ Rezultatet e pyetësorit pas trajnimeve.....	8
❖ Konkluzionet	12
❖ Rekomandimet	12

Hyrje

SCiDEV, bazuar në përvojën e krijuar dhe në interesin e ngjallur nga universitetet, pedagogët dhe studentët gjatë edicionin të parë “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare” (2019-2020), mbështetur nga Fondacioni për Shoqëria e Hapur për Shqipëri, nisi në Shtator 2020 një edicion të dytë të debatit, por duke pasur parasysh kontekstin e ri ku veprimet jo vetëm me hapjen e negociatave, por edhe me krizën shumë dimensionale social-ekonomike të shkaktuar nga COVID-19 si edhe me nevojën për një rini të angazhuar dhe të motivuar.

SCiDEV në edicionin e dytë të debatit universitar për integrimin iu përshtat dinamikave të reja të krijuara dhe sidomos kërkesës së studentëve jo vetëm për të qenë pjesë të debatit, por edhe për t’i mbështetur ata me një program të rritjes së kapaciteteve mbi veprimin dhe mbështetjen e të rinjve për aktivizim, sidomos aktivizim online. Në fazën e dytë u sugjerua përfshirja e 12 institucioneve për të patur mundësinë e thellimit të punës me studentët në Tiranë dhe Durrës dhe zgjerimi në Vlorë. Programi ‘Zhvillimi i kapaciteteve për studentët dhe kërkuesit e rinj’ është ndalur jo vetëm tek tematikat dhe formati i debatit (këto instrumente janë ndërtuar nga edicioni i parë dhe janë online), por tek aktivizimi, angazhimi dhe pjesëmarrja përmes zhvillimit të njohurive dhe aftësive sa i takon proceseve vendimarrëse brenda në Shqipëri e më gjerë, universitet, në komunitet, qytet në aspektin e angazhimit publik dhe politik kombëtar.

Ekspertët e SCiDEV janë angazhuar në një analizë kombëtare të politikeve rinore dhe pjesëmarrjes së të rinjve në politikëbërje dhe përmes dialogut me aktorët kryesore në fushën e rinisë kanë hartuar disa rekomandime konkrete ku puna rinore dhe aktivizimi e pjesëmarrja e të rinjve dalin në krye të listës. Lidhur me këto përvoja së bashku me Partnerët erdhi ideja e realizimit të këtij projekti ku Rrjeti Erasmus në Shqipëri (ESN Albania) që prej 2018 punon me të rinjtë sidomos në fushën e mobilitetit dhe lëvizshmërisë si edhe aktivizimit të tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Së bashku me të rinjtë e SCiDEV dhe të ESN Albania gjatë 2020 dhe 2021 kemi organizuar disa aktivitete të përbashkëta për pjesëmarrjen e të rinjve dhe temat që dalin në pah lidhen për zhvillimin e kompetencave për punën rinore dhe aktivizimit përmes invokacionit dhe krijimtarisë.

Gjithashtu SCiDEV dhe QSKN kanë bashkëpunuar që prej 2015 në disa projekte rinore si debati kombëtar, dhe ndërtimi i një dialogu konstruktiv për të shkuarën me të rinjtë në Shqipëri dhe rajon. Për më tepër, QSKN dhe partnerët kanë punuar së bashku në projekte rinore rajonale me RYCO me fokus mobilitetin digjital dhe hacking pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, pra duke përdorur inovacionin.

Objektivat e Trajnimeve dhe Projektit

- Së pari, fuqizimi i të rinjve përmes zhvillimit të kapaciteteve të tyre për punë dhe aktivizim rinor përmes inovacionit dhe kreativitetit.
- Së dyti, të angazhohen konkretisht të rinjtë në një fushatë "Fjala për Veprim" për të zgjidhur problemet konkrete të komunitetit të tyre me fokus në punën e të rinjve duke avokuar institucionet lokale, duke rritur ndërgjegjësimin publik dhe duke krijuar modele integriteti përmes aplikimit të njohurive nga trajnimet
- Së treti, zhvillimi i një fushate komunikimi strategjik dhe angazhimi mediatik për të rritur ndërgjegjësimin e institucioneve vendimmarrëse dhe publikut për punën me të rinjtë dhe promovimin e modeleve rinore me integritet që përdorin inovacionin, teknologjinë dhe kreativitetin për ndryshime sociale.

Realizimi i trajnimeve

Në lidhje me projektin gjatë muajit dhjetor 2021 janë realizuar [2 set trajnimesh online](#) për 60 të rinj nga ku 30 morën pjesë përmes platformës zoom ku ka patur trajnime të ndara në 2 grupe më të vogla në mënyrë që të ketë një interaktivitet sa më të lartë mes pjesëmarrësve. Trajnimet kanë qenë të fokusuar në Aktivizmin Publik dhe Politik dhe Metodave Digjitale të Aktivizimit të të rinjve duke bërë një historik të këtij të fundit dhe cilat janë arsyet që të rinjtë përqafojnë ose jo këtë lloj aktivizmi Gjithashtu gjatë këtyre trajnimeve të rinjtë kanë shprehur cilat janë fushat ku ata shohin primar aktivizmin dhe janë këshilluar nga trajnerët cilat mund të jenë disa ide të ndryshme nga ato që të rinjtë zakonisht ndërmarrin dhënë këshilla të vlefshme se si ata të krijojnë ide inovatore dhe me shumë kreativitet dhe cilat janë elementët e domosdoshëm që mund ti bëjnë ato ide fituese. Gjatë trajnimeve të rinjtë u njohën me trajtimin e origjinës së aktivizmit në përgjithësi duke bërë një kronologji të trendeve të atëhershme dhe të sotme ku mbizotërues është aktivizmi digjital si dhe u trajtuan metodat digjitale dhe platformat që po përdoren nga të rinjtë sot duke dhënë shembuj se ku ato kanë qenë të suksesshme bazuar edhe në situatën e dy viteve të fundit pandemike ku duket se të rinjtë i kanë përqaftuar këto lloj mënyrash për të bërë aktivizim Të rinjtë u trajnuan edhe në përdorimin e inovacionit dhe krijimtarisë për aktivizim rinor me shembuj konkretë nga RYCO dhe organizma të tjera si Këshilli i Europës. Ata janë pajisur gjithashtu me një [manual](#) të zhvillimit të kapaciteteve të të rinjve për avitvizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë.

Metodologjia e Vlerësimit


Grupi i punës për realizimin e trajnimeve dhe menaxheri i projektit kanë hartuar dy pyetësorë për pjesëmarrësit lidhur me njohuritë e tyre paraprake [para trajnimeve](#) dhe [pas trajnimeve](#) lidhur me aktivizmin. Qëllimi i pyetësorëve ishte vlerësimi i trajnimeve në aspektin personal, perceptimi i studentëve dhe eksperiencës së tyre me aktivizmit, cilat janë metodat më të përdorura dhe cilat kanë qenë faktorë ndihmues ose pengues për ta në ndërmarrjen e veprimtarive konkrete që janë gjeneruar nga vetë ta në këtë projekt. Pyetësorët përmbajnë 11 pyetje, prej të cilave 8 pyetje të mbyllura (me mundësi zgjedhjeje midis disa përgjigjeve, po/jo ose me vlerësim 1-5) dhe 3 pyetje të hapura me qëllim që studentët të shprehnin mendimin e tyre mbi eksperiencën e mëparshme dhe njohuritë e fituara pas trajnimeve. Link-u i pyetësorit iu dërgua të gjithë 60 studentëve pjesëmarrës nga Tre qytetet Korçë, Tiranë dhe Shkodër në bashkëpunim me partnerët ESN Tirana dhe QKSN.

Rezultatet e pyetësorit të parë

Pyetësorit i janë përgjigjur 48 nga 60 pjesëmarrësit e trajnimeve ose 75% e studentëve brenda afateve të përcaktuara kohore.

Pyetjet e mbyllura synonin të mblidhnin të dhëna mbi të studentët (cikli i studimeve, pjesëmarrja në fushata aktivizmi më parë dhe moshën e tyre si dhe Universiteti të cilit i përkisnin si edhe vlerësimi rreth faktorëve që i kanë penguar të jenë aktiv ku sipas grafikut 1 pjesa më e madhe e tyre janë në një moshë të re çka tregon se interesi i tyre drejt aktivizmit ka filluar hershëm.

Grafiku 1 Grupmosha e të rinjve pjesëmarrës



Përsa i përket Institucioneve pjesëmarrësit janë nga Universiteti i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Luigj Gurakuqi Shkodër, Universiteti Fan.S.Noli, Shkodër dhe janë me drejtime të shumëllojshme studimi si: Edukim fizik dhe sporte, Financë-Kontabilitet, Shërbim social, Matematikë-Informatikë, Arsimi Fillor, Gazetari & Komunikim, Marrëdhënie Ndërkombetare, Ing.Tekstile, Ekonomiks, Informatikë Binesi, Menaxhim Agrobiznesi etj.

Lidhur me pyetjet e hapura lidhur me çfarë është aktivizmi për ta të rinjtë shprehjet më të shpeshta që kanë dhënë të rinjtë në pyetësin e parë janë:

- *Aktivizim për mua do të thotë të merresh me aktivitete jashtë shkollës dhe punës që të ndihmojnë të zhvillosh aftësitë e tua të buta dhe aftësitë teknike dhe në të njëjtën kohë të ndikosh pozitivisht në komunitet.*
- *Aktivizmi për mua është përpjekja për të nxitur, penguar, drejtuar ose ndërhyrë në reforma shoqërore, politike, ose ekonomike me dëshirën për të bërë ndryshime në shoqëri drejt një të mire më të madhe.*
- *Është një formë e angazhimit në funksion të ndërgjegjësimit, përmirësimit, apo krijimit të një kauze.*
- *Aktivizmi është një aktivitet ku ti ngrin zërin e i jep një zgjidhje një problemi*


Rreth pyetjeve të anagazhimit të tyre të mëparshëm me aktivizmin një pjesë e mirë e të rinjve ka shprehur se është marrë kryesisht me punë dhe ndihmesa vullnetare për punën në komunitetet ku jetojnë si edhe një jetën universitare ku disa nga përgjigjet më të shpeshta qenë:

- *Jam aktivizuar për të ndihmuar njerëzit në komunitetin tim në kohën e karantinës me mjetet baze*
- *Kam qënë pjesëmarrëse në aktivitete të ndryshme me qëllim për të përmirësuar komunitetin tim.*

- Pjesëmarrja në keshillin studentor për të mbrojtur të drejtat e studentëve.
- Kam qenë pjesëmarrëse në protesta të ndryshme dhe trajnime për të rinjtë.
- Jam angazhuar në projekte të ndryshme për të drejtat e njeriut, të rinjve, para dhe tetraplegjikëve etj


Lidhur me pyetjen e pyetësorit të parë se cilat janë faktorët më pengues ku pyetja ka qenë e mbyllur me vlerësimin (1-5) për secilën arsye të renditur për të rinjtë ata kanë vlerësuar me 6 arsye të tjera që ata gjykojnë dhe më pas me % më të lartë me 5 kanë vlerësuar mungesën e kohës dhe më pas arsyet e tjera si stepja me mendimin se nuk do të sjellin ndryshim, nuk kanë gjetur nismën që ju përshtatet fokusit të tyre, nuk ka nisma të shumta në komunitetin ku banojnë si edhe pamundësia financiare.

Grafiku 2 Faktorët Pengues të të rinjve



Lidhur me pyetjen për aktivizimin online pjesa më e madhe kanë shprehur se kanë dijeni dhe e përdorin ndaj në kuadër të saj edhe trajnimet dhe sesionet kanë patur një prezantim të dedikuar rreth mjeteve digjitale që po përdorin të rinjtë sot në kuadër të nismave.

Grafiku 3 Përdorimi i metodave digjitale, dijenia dhe përdorimi i tij nga të rinjtë



Lidhur me këtë pyetje së hapur lidhur me cilin nga aktivizmat të rinjtë do të përshtateshin më shumë përgjigjet më të shpeshta qenë:

- *Më pëlqejnë të dyja llojet e aktivizmit por për shkak të profilit tim, mendoj se do punoja më mirë me aktivizmin online.*
- *Mendoj që në ditët e sotme duke marrë parasysh mundësitë që të ofron aktivizmi online për të pasur sa më shumë influencë ndikim dhe përfshirje do ishte idealja në momentin që nderthuret dhe me aktivizmin offline. Mendoj që të dyja kanë ndikim reciprok në realizimin e qëllimit të kauzës.*
- *Aktivizimi online*
- *Unë mendoj se do të përshtatesha më shumë nëpërmjet aktivizmit offline duke marrë parasysh shkallën e lartë të ndërveprimit krahasuar me atë online.*


Rezultatet e pyetësorit të dytë

Pas pjesëmarrjes në trajnime të rinjve pjesëmarrës ju dërgua një tjetër pyetësor të hartuar nga stafi menaxhues i projektit për të patur një ide më të qartë të përshtypjeve të tyre.

Në këtë pyetësor u përgjigjën 52 të rinj pjesëmarrës ose 86.6% e pjesëmarrësve totalë të trajnimeve.


Lidhur me pyetjen e parë nëse njohuritë e tyre pas trajnimeve janë zgjeruar 92.9% e tyre janë shprehur se njohuria e tyre rreth aktivizmit është zgjeruar.

Grafiku 1 Njohuritë e të rinjve pas trajnimeve




Gjate trajnimeve të rinjtë janë pajisur me një sërë metodash dhe mënyrash si ata mund të bëjnë aktivizëm dhe cilat platforma po përdoren më shumë e cilat janë më të përshtatshme sot. Lidhur me këtë 35.7% e tyre janë përgjigjur se Organizimet Publike si Protestat dhe të njëjtën rëndësi i kanë dhënë edhe mediave sociale duke I vënë në barazpeshë të dy këto metoda.

Grafiku 2 Metodat më të përshtatshme për aktivizëm sipas të rinjve




Rreth pyetjes se cilët janë elementët që do të bënin nismat e tyre të suksesshme 85.7% e të rinjve të rinjtë kanë vlerësuar me 5 Faktorin e Qartësisë dhe fokusimit te vetëm një çështje, duke renditur më pas faktorin e kërkimit të angazhimit edhe nga të tjerë, të jenë të matshme dhe të realizueshme në kohë, të kenë një fokus-grup kryesor si edhe të përdorin metodat online dhe offline për implementimin e tyre me 35.7% .Të rinjtë kanë patur opsionin për të zgjedhur më shumë se një nga elementët.

Grafiku 3 Elementët që duhet të kenë nismat në mënyrë që të jenë të suksesshme




Përsa i përket pyetjes se cilat nga fushat shohin si immediate për aktivizim të rinjte rendisin Arsimin, duke lënë pas Papunësinë, Korrupsionin dhe Kushtet e vështira Social-Ekonomike dhe faktorë të tjerë. Të rinjtë kanë patur mundësinë të zgjedhin më shumë se një opsion.

Grafiku 4 Fushat që kanë nevojë për ndërhyrje të shpejtë nga të rinjtë



Rreth pyetjes së mbyllur se cilat nga metodat do tu vinin në ndihmë në realizimin e nismës së tyre të rinjtë pjesëmarrës kanë vlerësuar me 5 faktorin: Mediat Sociale, më tej Vullnetarizmin, aktivizmin përmes artit, kërkimin dhe publikimin e gjetjeve dhe peticionet.

Grafiku 5 Metodat që do t’ju vinin në ndihmë më shumë të rinjve në implementimin e nismave të tyre



Pyetjes së hapur se cilat do të ishin disa nga idetë për aktivizim përmes invocaionit dhe krijimtarisë të rinjtë ju përgjigjën me shumë ide, por ato që u veçuan dhe sollën edhe përzgjedhjen e 15 të rinjve pjesëmarrës janë:

- Aktivizëm rreth problematikes se transportit publik ne Tiranë
- Aktivizëm përmes gjithëpërfshirjes së të rinjve përmes artit
- Aktivizëm për të përmirësuar e gjallëruar rolin e universitetit.

Të përzgjedhurit kanë qenë studentët:

Qyteti i Tiranës	Qyteti i Shkodrës	Qyteti i Korçës
Anisa Omeri	Armando Lekaj	Eljona Topi
Julian Sopaj	Elsa Pjetra	Flori Hasanllari
Klea Dahari	Gilman Kallaçi	Livja Topi
Kevin Topi	Marie Kola	Marina Malësori
Sara Frroku	Syrjan Rahova	Vasil Ciko

Përsa i përket të përzgjedhurve ata kanë vlerësuar se disa nga mënyrat advokuese për fushatën e ndërmarrë prej tyre janë:

- *Diskutime publike offline me studentët, si dhe ngritja e shqetësimit online nëpërmjet rrjeteve sociale.*
- *Infosesionet në universitete, publikime e fushatat në rrjetet sociale , pyetësorë ku do kenë akses të gjithë për ti plotësuar*
- *Mediat sociale janë një mënyrë shumë e mirë për të shpërndarë informacion për aktivizmin si dhe për të nxitur interes.*
- *Nëpërmjet mediave*
- *Nëpërmjet takimeve dhe eventeve publike*

Konkluzione

Pyetësorët “Vlerësim rreth qasjes së të rinjve ndaj aktivizmit” dhe “Verësim i programit të Trajnimeve “ në kuadër të projektit “Nga fjala tek Veprimi-Aktivizëm për punën rinore përmes inovacionit dhe krijimtarisë i organizuar nga SCiDEV, QKSN dhe ESN Tirana konfirmoi se përzgjedhja e tematikave për trajnim dhe përgatitja e tyre kanë qenë shumë të nevojshme dhe të volitshme për të gjithë studentët. Tematikat e trajnimeve kanë sjellë përfundim të analizës dhe të menduarit kritik, ka nxitur krijimtarinë dhe ka rritur njohuritë e tyre mbi platformat digjitale dhe modelet e suksesshme në vend e rajon. Trajnimet nxorën në dukje interesimin e studentëve për tu thelluar edhe më tepër lidhur me temat e trajtuara por edhe domodoshmërinë e trajnimeve të tilla që i nxisin ata për të qenë më aktiv në jetën publike dhe aktivizmin qytetar duke përdorur platforma të ndryshme. Programi i trajnimit të studentëve të kapaciteteve të studentëve bashkoi të rinj të Universiteteve të ndryshme nga 3 qytetet e vendit të cilët bashkëbiseduan, ndanë mendime e dhanë propozimet e tyre duke kontribuar kështu në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për rolin e tyre si qytetarë aktivë të vendit duke thelluar njohuritë e tyre dhe duke përdorur inovacionin për të vënë në jetë nismat e ardhura nga krijimtaria e tyre.

Rekomandime

- Të punohet për rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të studenteve si të rinj aktivistë dhe të angazhuar në shoqëri.
- Të punohet për njohjen e studentëve më tepër me platformat digjitale dhe si ti përdorin ato
- Të krijohet një sinergji mes studentëve për të bashkuar njohuritë e tyre sipas fushave studimore krijimtari+ inovacion për ta bërë aktivizmin sa më kreativ
- Të synohet gjithëpërfshirja e studentëve në trajnime dhe aktivitete me qëllim
- ndërgjegjësimin e studentëve për rolin e tyre në komunitet dhe shoqëri.
- Të zhillohet edhe më tej Programi i Trajnimeve me më shumë tema, takime e diskutime me interes për studentët.
- Të përforcohet bashkëpunimi me aktorë të tjerë me fokus të rinjtë dhe nevojat e komunitetit